



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 17, 24 dhe 40 të Ligjit, Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 27, 28 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 dhe konform Rregullores për ndarjen e subvencioneve 01-Nr-16-586, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren për ndryshim plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 01-Nr-110-47552, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.05.2024, miraton këtë:

V E N D I M

Për mbulimin e shpenzimeve të varrimit

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet që shuma financiare për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për qytetaret e Komunës së Suharekës, të jetë **250.00€ (dyqind e pesëdhjetë euro)** për 1, (një) varrim.

Neni 2

Autorizohet-Kryetari i Komunës që të lidh marrëveshje me shkrim me Bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e Komunës së Suharekës për kryerjen e shërbimeve të varrimit, konform dispozitave të këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi

Neni 3

3.1 Subvencionimi i shpenzimeve për shërbime të varrimit do të bëhet për çdo person të vdekur për të cilin në bazë ekzaminimit mjekësor dhe në pajtim me dispozitat ligjore është konstatuar vdekja e tij.

3.2 Në kuadër të shërbimeve të varrimit për komunitetin fetar Islam përfshihen këto shërbime: 1. Transporti i kufomës brenda territorit të Komunës së Suharekës (bartja e kufomës nga shtëpia deri në xhami (vend falja e kufomës) dhe përcjellja deri te varrezat), 2. Hapja dhe mbyllja e varrit (sipas traditave fetare Islame), 3. Dërrasat (pa arkivol) me të cilat mbulohet kufoma pas lëshimit në varr me dimensione 2.10 x 1.10 x 0.5, 4. Qefini mbështjellës i veçanët për kufomën sipas parimit Islam dhe mjetet higjienike përfshirë (dorëzat higjienik, pambuk, shamponi dhe sapuni), 5. Piramida (dërrasë me mbishkrimin e të dhënave të të vdekurit dhe ngjyrosja), 6. Dezinfektimi i veturës dhe flet lajmërimet 30 copa.

3.3 Në kuadër të shërbimeve të varrimit për komunitetin fetar Katolik përfshihen këto shërbime: 1. Transporti i kufomës brenda territorit të Komunës së Suharekës (bartja e kufomës nga shtëpia deri te varrezat), 2. Hapja dhe mbyllja e varrit (sipas traditave fetare Katolike), 3. Dërrasat (pa arkivol) me të cilat mbulohet kufoma pas lëshimit në varr me dimensione 2.10 x 1.10 x 0.5, 4. Kryqi (si pas traditave fetare katolike), 5. Dezinfektimi i veturës dhe flet lajmërimet 30 copa.

Neni 4

4.1 Drejtoria përkatëse pas pranimit të raportit-listën me shkrim mbi vdekjet me dokumentacionet e bashkangjitura nga ana e bashkësisë fetare, bënë ekzekutimin e pagesave në baza mujore.

4.2 Në rastet që mund të ndodh në vonesat e lidhjes së marrëveshjes për shkaqe të ndryshme me ndonjërin nga bashkësitë fetare, subvencionimi i qytetarëve të atij komuniteti fetar do të bëhet sipas kërkesës individuale, konform raporti të bashkangjitura dhe dokumentacionit tjetër përkatës deri në shumën e përcaktuar në nenin 1 të këtij vendimi.



Neni 5

5.1 Mjetet financiare për mbulimin e shërbimeve të varrimit do të paguhen nga buxheti i Komunës, nga kategoria ekonomike e subvencioneve, kodi i programit 21/624/73021/200/22298/0760 të planifikuar në Administratën e Shëndetësi (pagesa për shpenzimet e varrimit).

5.2 Mjetet financiare do të lëshohen në xhirrollogarinë e bashkësisë fetare përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të varrimit.

5.3 Në rast se brenda vitit fiskal nuk ka mjete të mjaftueshme të planifikuar në Administratën e shëndetësi, shpenzimet e shërbimeve të varrimit do të paguhen edhe nga kodet tjera programore të kategorisë së subvencioneve të Drejtorive tjera.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në bashkëpunim me Drejtorin për ekonomi, financa dhe buxhet të Komunës së Suharekës.


Neni 7

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 06-29994
Me datë 30-05-2024



Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI

